

**PËRMBAJTJA E DOKUMENTACIONIT DHE PROCEDURA PËR PAJISJE ME LEJE SHFRYTËZIMI, KONFORM KËRKESAVE TË LIGJIT NR.7796, DATË 17.02.1994, “MINERAR I SHQIPËRISË”,  
ndryshuar me LIGJIN NR.9261, DATË 22.7.2004**

Procedurat për marrjen e një leje shfrytëzimi, ndjekin rradhën e mëposhtme:

- Paraqitja e kërkesës paraprake për pajisje me leje shfrytëzimi në METE  
Kjo kërkesë përmban:
  - disa të dhëna të shkurtra për subjektin;
  - koordinatat kufizuese të zonës që kërkohet;
  - një hartë në shkallë 1:25 000, me zonën e kërkuar.
- Pas paraqitjes së kësaj kërkesë, sipas nenit 47, Ministri duhet të sigurohet se toka që jepet për shfrytëzim minerar është survejuar siç duhet, me parë se të jepet leja e shfrytëzimit.
- Për këtë qëllim, Ministri mund të drejtojë kërkuesin e Lejes së Shfrytëzimit që të përgatisë një survejim me shpenzimet e vetë kërkuesit në lidhje me kërkesa që specifikohen në rregulloren e miratuar prej tij.
- Akti i kqyrjes apo verifikimi i sipërfaqes së tokës që kufizohet në hartën e zonës së kërkuar për marrjen e lejes minerare të shfrytëzimit, kryhet nga AKBN ose METE.
- Në rastin kur kryhet në AKBN, subjekti i interesuar merr përgjigje brenda 10 ditëve.
- Pas kryerjes së aktit të verifikimit, Ministri, brenda 30 ditëve, i kthen përgjigje subjektit të interesuar për vazhdimin ose jo të procedurave të mëtejshme për marrjen e Lejes Minerare të Shfrytëzimit dhe e fton atë të paraqesë brenda 90 ditëve dosjen me dokumentacionin përkatës për marrjen e Lejes Minerare të Shfrytëzimit.

Dosja përkatëse për marrjen e lejes minerare të shfrytëzimit duhet të përmbajë dokumentat e mëposhtëm:

1. Kërkesën për pajisje me leje shfrytëzimi;  
Forma dhe përmbajtja e kërkesës, për marrjen e Lejes Minerare të Shfrytëzimit, përcaktohen me rregullore të miratuar nga Ministri.
2. Vendimin e Gjykatës për regjistrimin e personit juridik “Emri i subjektit” Sh.p.k. (ku të përfshihet aktiviteti në shfrytëzim, prodhim, përpunim dhe eksport mineralesh e hidrokarburesh, si dhe në rastet kur gjykohet e domosdoshme, edhe nevoja e përdorimit të lëndëve plasëse dhe materialeve shpërthyese);
3. Çertifikatën e regjistrimit të personit juridik në organet tatimore (NIPT);
4. Vërtetim nga organet tatimore, që shoqëria nuk ka detyrime të pashlyera;

5. Vërtetimin nga Banka me Nr. e Llogarisë së Shoqërisë dhe burimet financiare për zhvillimin e aktivitetit;
6. Mendimin e Pushtetit Vendor, ku ndodhet objekti, për lejimin e shfrytëzimit të objektit mineral;
7. Mendimin e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor, ku ndodhet objekti për lejimin e shfrytëzimit të objektit mineral;
8. Lejen mjedisore të dhënë nga Ministria e Ambientit;
9. Kontratën e punës me drejtuesin teknik (inxhinier miniere);
10. Studimin tekniko-ekonomik dhe projektin e shfrytëzimit të objektit.
11. Oponencën e studimit tekniko-ekonomik dhe projektit të shfrytëzimit të objektit dhe vendimin e Këshillit Teknik të AKBN.

Procedura e përcaktuar në pikën 11 në AKBN zgjat 10 ditë nga data efektive e dorëzimit të studimit dhe projektit në AKBN.

Pas plotësimit të dosjes dhe dorëzimit të saj në METE, sipas paragrafit të dytë të nenit 47, të Ligjit Mineral në fuqi, Ministri duhet të njoftojë kërkuesin e lejes së shfrytëzimit për vendimin e tij mbi kërkesën, brenda 90 ditëve pas marrjes së saj.